



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

UDHËZUES

PËR PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE SHPËRBLIMIT TË
SPECIALISTËVE TË JASHTËM ME KONTRATË DHE BASHKËPUNËTORËVE
NË PROJEKTE ME KONTRATË, PËR REALIZIMIN E VEPRIMTARIVE
ZHVILLIMORE TË AKAFPK

TIRANË 2023

I. Objekti dhe qëllimi

Udhëzuesi ka për objekt përcaktimin e procedurës dhe kritereve të përzgjedhjes së specialistëve të jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorëve të projekteve me kontratë, si dhe të modaliteteve të shpërblimit të tyre.

Udhëzuesi ka për qëllim garantimin e pjesëmarrjes aktive të specialistëve të jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorëve të projekteve me kontratë, në përmbushje të detyrave të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (më poshtë AKAFPK) në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të saj, si dhe sigurimin e barazisë dhe transparencës së procesit të përzgjedhjes dhe shpërblimit të tyre.

II. Baza ligjore

Ky Udhëzues bazohet kryesisht në aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

1. Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
2. Ligjin nr. 15/2017, datë 16.02.2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë";
3. Ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve", të ndryshuar;
4. Ligjin nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
5. Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve Publike", i ndryshuar;
6. Ligjin nr. 117/2014, datë 11.09.2014 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin "Erasmus +", programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin".
7. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 16.10.2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve";
8. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 26.6.2019 "Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të Komiteteve Sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre";
9. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 322, date 02.06.2021 "Për një shtesë në vendimin nr. 656, datë 31.10.2018, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësisë të qeverisjes qendrore", të ndryshuar.
10. Urdhrin nr. 128, datë 06.07.2021, i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për miratimin e "Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional";
11. Rregulloren nr. 24/1 prot., datë 17.02.2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve";

12. Shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm të MAS-it, nr. 2100/1 prot., datë 03.04.2014 "Kthim përgjigje", të shkresës nr. 63, datë 25.03.2014 të AKAFPK "Mbi prokurimin elektronik të shërbimeve të specializuara në fushën e veprimtarisë së AKAFPK", shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm të MAS-it, nr. Prot., 4290/2, datë 05.12.2013 "Mbi raportin final me rekomandime të Auditit të realizuar nga MAS nga data 09.09.2013 deri më datë 20.09.2013" (pika nr. 3 e rekomandimeve).

III. Subjektet

1. Subjektet janë specialistët e jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorët në projekte me kontratë, të cilët kërkojnë të ofrojnë shërbimet e tyre për të ndihmuar AKAFPK-në në realizimin e detyrave të saj, sipas nenit 13 të rregullores nr. 24/1 prot., datë 17.02.2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve".
2. Komisioni i ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKAFPK-së do të realizojë përzgjedhjen e specialistëve të jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorëve në projekte me kontratë, sipas procedurave të përcaktuara në këtë Udhëzues.

IV. Njoftimet për rekrutimin e specialistëve të jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorëve në projekte me kontratë

1. Njoftimet për aplikim të kandidatëve për specialistë të jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorë në projekte me kontratë, miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i AKAFPK, bazuar në kërkesat e drejtorive/sectorëve përkatës për një detyrë të caktuar, dhe përmbajnë:
 - a) specifikimet e detyrës për të cilën do të angazhohen specialistët e jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorët në projekte me kontratë;
 - b) kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për përzgjedhjen e tyre;
 - c) listën e dokumenteve që duhet të paraqesin;
 - d) mënyrën e aplikimit;
 - e) afatet e aplikimit;
 - f) numrin minimal dhe maksimal të anëtarëve të grupit për detyrën përkatëse;
 - g) kohëzgjatjen e kontratës.
2. Publikimi i njoftimit për shpalljen e kërkesave për specialistë të jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorë në projekte me kontratë, bëhet në faqen zyrtare të internetit të AKAFPK-së.

V. Kategoritë e specialistëve të jashtëm me kontratë

1. Specialistët e jashtëm me kontratë ndahen në tri kategori (referuar Pikës 9 të VKM-së nr. 673, datë 16.10.2019):

- a) Specialistë të kategorisë së ulët, individë që kanë një diplomë të arsimit të mesëm dhe përvojë pune mbi 3 vjet, në fushën për të cilën lidhet kontrata;
- b) Specialistë të kategorisë së mesme, individë që kanë një diplomë të arsimit të lartë ("Bachelor"/niveli 6 i KSHK-së) në fushën për të cilën lidhet kontrata dhe kanë një përvojë pune mbi 5 vjet në fushën përkatëse;
- c) Specialistë të kategorisë së lartë, individë që kanë një diplomë të ciklit të dytë dhe/ose të tretë të studimeve ("Master i shkencave", "Master Profesional", "Doktoratë", niveli 7-8 i KSHK-së), sipas legjislacionit për arsimin e lartë, në fushën për të cilën lidhet kontrata dhe kanë një përvojë pune mbi 10 vjet, në fushën përkatëse.

VI. Kërkesat për përzgjedhjen e specialistëve të jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorëve në projekte me kontratë

1. Specialistët e jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorë në projekte me kontratë duhet të plotësojnë kërkesa të përgjithshme dhe kërkesa të veçanta që hartohen në funksion të veprimtarive zhvillimore për të cilat do të kontraktohen (referuar Lidhjes nr. 2 të VKM nr. 673, datë 16.10.2019 "Për organizimin dhe funksionimin e AKAFPK-së" dhe marrëveshjeve kuadër për projektet, si më poshtë:
 - a) të kenë aftësi komunikuese me shkrim dhe me gojë
 - b) të kenë aftësi të punës në grup
 - c) të përdorin programet bazë të kompjuterit
 - d) të zotërojnë teknikat e komunikimit elektronik
 - e) të përdorin literaturë në gjuhë të huaj
3. Kërkesat e veçanta, referuar detyrave përkatëse sipas VKM nr. 673, datë 16.10.2019 "Për organizimin dhe funksionimin e AKAFPK-së", pikave 8, 9 dhe 10 dhe Lidhjes nr. 2 të këtij vendimi.
 - 3.1. Për hartimin dhe rishikimin e produkteve që përfshihen në pikat I, II, V, XII, XIII dhe XVIII të Lidhjes nr. 2 të këtij vendimi.
 - a) të kenë mbaruar arsimin e mesëm ose të lartë në fushën përkatëse profesionale;
 - b) të kenë përvojë pune në fushën profesionale përkatëse dhe/ose mësimdhënie në kulturën profesionale të arsimit të mesëm dhe/ose të arsimit të lartë, në fushën profesionale përkatëse;
 - c) të kenë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme trajnuese për zhvillimin e tyre profesional.
 - d) kërkesa të tjera të veçanta, referuar llojeve dhe veçorive të produktit përkatës.

3.2. Për hartimin dhe rishikimin e produkteve që përfshihen në pikat III, IV dhe XVII të Lidhjes nr. 2 të këtij vendimi.

- a) të kenë të paktën arsimin e mesëm dhe kualifikime në fushën përkatëse profesionale;
- b) të kenë, përvojë pune në fushën profesionale përkatëse ose në mësimdhënie në kulturën profesionale të arsimit të mesëm dhe/ose të arsimit të lartë, në fushën profesionale përkatëse (të paktën, 3 vite e fundit);
- c) të kenë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme trajnuese për zhvillimin e tyre profesional.
- d) kërkesa të tjera të veçanta, referuar llojeve dhe veçorive të produktit përkatës.

3.3. Për hartimin dhe rishikimin e produkteve që përfshihen në pikat VI dhe VII të Lidhjes nr. 2 të këtij vendimi:

- a) të kenë mbaruar arsimin e mesëm ose të lartë në fushën përkatëse profesionale;
- b) të kenë përvojë pune si mësimdhënës të teorisë dhe/ose praktikës profesionale në formimin profesional, në arsimin e mesëm profesional dhe në arsimin e lartë, në fushën profesionale përkatëse;
- c) kërkesa të tjera të veçanta, referuar llojeve dhe veçorive të produktit përkatës;

3.4. Për hartimin dhe rishikimin e dokumenteve që përmbajnë veprimtaritë në Pikat IX dhe XI:

- a) të kenë diplomë të arsimit të lartë (të paktën niveli 7 i KSHK-së);
- b) të kenë përvojë si trajnerë të mësimdhënësve të AFP-së;
- c) të kenë përvojë në përgatitjen e programeve dhe materialeve të trajnimit të mësimdhënësve të AFP-së;
- d) të kenë përvojë pune si mësimdhënës në AFP dhe/ose në arsimin e lartë;
- e) kërkesa të tjera të veçanta, referuar llojeve dhe veçorive të produktit përkatës;

3.5. Për hartimin dhe rishikimin e dokumenteve që përmbajnë veprimtaritë në Pikën X:

- a) të kenë diplomë të arsimit të lartë;
- b) të kenë përvojë si mësimdhënës në fushën/lëndën përkatëse;
- c) të kenë aftësi për të përgatitur materiale të shkruara;
- d) kërkesa të tjera të veçanta, referuar llojeve dhe veçorive të produktit përkatës;

3.6. Për realizimin e veprimtarive që përmbahen në Pikën VIII:

- a) të kenë përfunduar arsimin e lartë (të paktën niveli 7 i KSHK-së);
- b) të kenë jo më pak se 5 vite përvojë pune, në AFP dhe/apo në fushat profesionale përkatëse;
- c) të jenë të certifikuar si vlerësues të jashtëm të procesit të akreditimit;
- d) të kenë ndjekur me sukses trajnimet për vlerësues të jashtëm të akreditimit, të miratuar dhe të zhvilluar nga AKAFPK-ja;

- e) të mos jenë të përjashtuar nga e drejta për të vepruar si vlerësues të jashtëm të procesit të akreditimit.
- f) të kenë nënshkruar formularin e deklaramit që nuk kanë konflikt interesi me AKAFPK-në dhe me ofruesin e AFP-së.
- g) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale.

3.7. Për realizimin e veprimtarive që përmbahen në Pikën XX:

- a) të kenë diplomë të arsimit të lartë (të paktën niveli 7 i KSHK-së);
- b) të kenë jo më pak se 5 vite pune përvojë, sipas fushave përkatëse, të akreditimit të qendrave për njohjen e të nxënit të mëparshëm;
- c) të jenë të certifikuar si vlerësues të jashtëm të procesit të akreditimit të qendrave për njohjen e të nxënit të mëparshëm
- d) të ketë ndjekur trajnimin e vazhduar për këtë proces.
- e) të mos jenë përjashtuar nga e drejta për të vepruar si vlerësues i jashtëm.
- f) të kenë nënshkruar formularin e deklaramit që nuk kanë konflikt interesi me AKAFPK-në dhe qendrën e njohjes së të nxënit të mëparshëm.
- g) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale.

3.8. Për realizimin e veprimtarive që përmbahen në Pikën XV:

- a) të kenë diplomë të arsimit mesëm dhe/ose të lartë në fushën përkatëse;
- b) të kenë përvojë në mësimdhënie dhe/ose në profesion në fushën përkatëse.
- c) të mos kenë qenë anëtarë të grupeve të hartimit dhe rishikimit të produkteve të përfshira në Pikën XV.

3.9. Për realizimin e veprimtarive që përmbahen në Pikën XVI:

- a) të kenë diplomë të arsimit të lartë (të paktën niveli 7 i KSHK-së);
- b) të kenë përvojë në moderim të proceseve të hartimit dhe formatimit të dokumenteveve sipas pikave I-XIII;
- c) kërkesa të tjera të veçanta, referuar llojeve dhe veçorive të produktit përkatës.

3.10. Për realizimin e veprimtarive që përmbahen në Pikën XIX:

- a) të kenë diplomë të arsimit të lartë (të paktën niveli 7 i KSHK-së);
- b) të kenë përvojë si trajner i mësimdhënësve;
- c) kërkesa të tjera të veçanta, referuar veçorive të trajnimit përkatës.

VII. Kërkesat për përzgjedhjen e anëtarëve të komiteteve sektoriale

1. Anëtarët e komiteteve sektoriale duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme, referuar VKM Nr. 426, datë 26.6.2019 "Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyrën e shpërbllimit të tyre":

- a) Të jenë përfaqësues në një nga subjektet apo sektorët si vijon:

- a)1. shoqatat e punëdhënësve të sektorit përkatës, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës, me përvojë jo më pak se 3 (tre) vjet në sektorin përkatës;
- a)2. shoqatat e punëmarrësve të sektorit përkatës, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës, me përvojë jo më pak se 3 (tre) vjet në sektorin përkatës;
- a)3. përfaqësues të biznesit me praktika të pasura në zhvillimin e burimeve njerëzore në sektorin përkatës, me përvojë jo më pak se 3 (tre) vjet në sektorin përkatës;
- a)4. ekspertë të pavarur, me përvojë jo më pak se 5 (pesë) vjet në zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve,
- b) Të jenë njohës të mirë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;
- c) Të jenë njohës të mirë të sektorit përkatës;
- d) Të kenë përvojë të provuar për zhvillimin dhe zbatimin e KSHK-së;
- e) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- f) Të kenë aftësi për të përdorur literaturë në gjuhë të huaj;
- g) Të kenë mbaruar arsimin e lartë në fushën/drejtimin përkatës ose arsimin e mesëm profesional në fushën/drejtimin përkatës.

VIII. Dokumentacioni që duhet të paraqesin specialistët e jashtëm me kontratë

1. Kandidatët për specialistë të jashtëm me kontratë duhet të paraqesin këto dokumente, në gjuhën shqipe:
 - a) Kërkesë për Aplikim referuar njoftimit përkatës për aplikim;
 - b) Curriculum Vitae;
 - c) Fotokopje e dokumenteve të diplomimit/certifikimit që vërtetojnë kualifikimin përkatës;
 - d) Dokument zyrtar që vërteton kohëzgjatjen e përvojës në punë, në fushën përkatëse (fotokopje të librezës së punës, dokument nga e-albania dhe/apo çdo dokument tjetër zyrtar që plotëson këtë kërkesë);
 - e) Kopje të certifikatës si vlerësues i jashtëm i proceseve të akreditimit (vetëm për kandidatët e proceseve të akreditimit).
 - f) Dëshmi penaliteti (vetëm për kandidatët e proceseve të akreditimit).
 - g) Deklaratën e konfliktit të interesit (vetëm për kandidatët e proceseve të akreditimit).
 - h) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kryerjen e kualifikimeve, trajnimeve dhe specializimeve të ndryshme (në se disponohen).
2. Kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, si dhe dokumentacioni i nevojshëm për bashkëpunëtorët në projekte me kontratë, përcaktohen sipas llojit të detyrës dhe modaliteteve të marrëveshjes së financimit të projektit përkatës.

IX. Ngritja dhe përbërja e komisionit të përzgjedhjes së specialistëve të jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorëve në projekte me kontratë (më poshtë "Komisioni")

1. Komisioni për përzgjedhjen e specialistëve të jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorëve në projekte me kontratë ngrihet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm.

2. Komisioni përbëhet nga:

- a) Drejtori i përgjithshëm i AKAFPK-së (kryetar komisioni);
- b) Drejtor i Drejtorisë së Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale (anëtar);
- c) Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) (anëtar);
- d) Përgjegjës i Sektorit të Akreditimit të Ofruesve të AFP-së (anëtar);
- e) Përgjegjës i Sektorit të Administratës, Financës dhe Teknologjisë së Informacionit (anëtar).

X. Përzgjedhja e specialistëve të jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorëve në projekte me kontratë

1. Përzgjedhja e specialistëve të jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorëve në projekte me kontratë, bëhet nga Komisioni i ngritur me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, referuar pikës IX.
2. Vlerësimi i kandidatëve konkurrues bëhet mbi bazën e kërkesave të shpallura dhe dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët.
3. Komisioni merr vendimin për shpalljen e fituesve dhe harton procesverbalin përkatës.
4. Në përfundim të procesit të përzgjedhjes, njoftimi për fituesit publikohet në faqen e internetit të AKAFPK-së.

XI. Vlerësimi i kandidatëve për specialistë të jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorëve në projekte me kontratë

1. Komisioni shqyrton dokumentacionin e kandidatëve për specialistë të jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorëve në projekte me kontratë.
2. Në ato raste kur, specialistët e jashtëm do të punojnë në përbërje të grupeve dhe nuk plotësohet numri minimal i përcaktuar në njoftim, komisioni nuk e shqyrton, por shtyhet afati i aplikimit me njoftim, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.
3. Në rast se numri i kandidatëve që plotësojnë kriteret është më i vogël se sa numri minimal i grupit të specialistëve i shpallur në njoftim (ose për arsye të tjera), komisioni vendos shtyrjen e afatit të aplikimeve.
4. Në të gjitha rastet që ka shtyrje afatesh për aplikim, kandidatët që kanë aplikuar më parë nuk është e nevojshme të ri aplikojnë.
5. Komisioni mban procesverbal lidhur me vlerësimin e kandidatëve së bashku me rezultatet e vlerësimit dhe shpall listën e fituesve.

XII. Ankesa

1. Kandidatët për specialistë të jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorët në projekte me kontratë, kanë të drejtë të bëjnë ankesë për vendimin e Komisionit brenda një afati prej 2

ditësh pune nga data e publikimit të njoftimit për fituesit, në adresën zyrtare të internetit të AKAFPK.

2. Komisioni shqyrton ankesat e kandidatëve, specialistë të jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorëve të projekteve me kontratë, dhe marrin vendimet brenda 2 ditëve pune nga data e paraqitjes së ankimit.

XIII. Lidhja e Kontratave

1. Pas shpalljes së vendimit përfundimtar për fituesit në faqen zyrtare të AKAFPK-së specialistët e jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorët në projekte me kontratë, duhet të paraqiten jo më vonë se 5 ditë pune nga shpallja e njoftimit për të lidhur kontratë, shërbimi individuale.

XIV. Të drejtat dhe detyrat e specialistëve të jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorëve në projekte me kontratë

1. Specialistët e jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorët në projekte me kontratë, gëzojnë të gjitha të drejtat që u njeh ligji dhe kontratat e lidhura me AKAFPK-në.
2. Specialistët e jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorët në projekte me kontratë, kanë për detyrë të përmbushin të gjitha detyrimet që burojnë nga kontrata e lidhur.

XV. Trajtimi financiar i specialistëve të jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorëve në projekte me kontratë

1. Trajtimi financiar i specialistëve të jashtëm me kontratë bëhet sipas Pikës 9 dhe Pikës 10 të VKM-së nr. 673, datë 16.10.2019.
2. Në mbështetje të pikës XIV të Lidhjes nr. 2, të VKM-së nr. 673, datë 16.10.2019, specialisti i sektorit përkatës, drejtuesi i grupit përgatit një relacion shpjegues për shkallën e rishikimit të dokumenteve që janë në zbatim, për të cilët ka punuar grupi i specialistëve të jashtëm me kontratë.
3. Në rast se orët e punës për kryerjen e veprimtarive zhvillimore tregohen me intervale, orët e punës për të cilat do të lidhen kontratat, do të llogariten sipas kriterëve të përcaktuara në Lidhjen nr. 2 të detajuar, bashkëlidhur këtij Udhëzuesi.
4. Modalitet e vëllimit të kohës së punës përcaktohen sipas Lidhjes nr. 2 të detajuar bashkëlidhur këtij Udhëzuesi.
5. Specialisti i sektorit përkatës, drejtuesi i grupit të specialistëve të jashtëm për zhvillimin e dokumenteve përmbajtësorë, sipas pikave I-VII dhe IX- XV të Lidhjes nr. 2 të detajuar të këtij Udhëzuesi, përgatit raportin e vlerësimit të kontributit të secilit anëtar grupi dhe ndarjen e vëllimit të kohës së punës për secilin prej tyre, jo më shumë se vëllimi total i përcaktuar në Lidhjen 2 të detajuar, të këtij Udhëzuesi.
6. Drejtori i Përgjithshëm i AKAFPK-së nënshkruan kontratat me secilin specialist të jashtëm me kontratë, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e secilës palë.

7. Pagesa për secilin specialist të jashtëm me kontratë, kryhet nga buxheti i AKAFPK-së nëpërmjet Urdhër-pagesave.
8. Trajtimi financiar i anëtarëve të komiteteve sektoriale bëhet sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 322, date 02.06.2021 “Për një shtesë në vendimin nr. 656, datë 31.10.2018, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.
9. Pagesat për procesin e akreditimit të IoAFP-ve:
 - a) Kryetari i Grupit të Vlerësuesve të Jashtëm (GVJ) paguhet për punën shtesë 10% e totalit të vëllimit të orëve të nevojshme për kryerjen e procesit të akreditimit.
 - b) Pagesa kryhet pas përbushjes së procedurës së akreditimit, në tri fazat kryesore (referuar fazës së III-të, pika “b” të nenit 10 dhe pika 5 të nenit 17 të Urdhrit nr.128, datë 06.07.2021).
10. Trajtimi financiar i bashkëpunëtorëve në projekte me kontratë bëhet sipas modaliteteve të marrëveshjes së financimit të projektit përkatës.

XVI. Publikimi i njoftimeve

Të gjitha njoftimet lidhur me procedurat e aplikimit për specialistë të jashtëm me kontratë dhe bashkëpunëtorët në projekte me kontratë, gjenden në adresën e faqes zyrtare të internetit të AKAFPK-së, www.akafp.gov.al.